



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 31001-00500-00-2016 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 00-2023- 307 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Asim VOKSHI - Kryesues
Arbena AHMETI - Anëtare
Gentian MEDJA - Anëtar

sot më datë 02.02.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 31001-00500-00-2016, që u përket palëve:

PADITËS: Altin Morina

I PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 3, datë 06.01.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, vendimit nr. 13, datë 02.02.2015, për shqyrtimin e ankesës për masë disiplinore dhe Urdhrit nr. 102/1, datë 04.02.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si akte administrative të paligjshme.
Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.
Detyrimin e palës së paditur të më rikthejë në punë në Policinë e Shtetit në funksione të barazvlefshme me gradën “Nënkomisar”.

BAZA LIGJORE: Neni 44 i Kushtetutës, Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Kodi i Punës, Kodi i Procedurës Civile, ligji nr. 152/2012 “Për nëpunësin civil”, Rregullorja e Personelit e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 804, datë 21.11.2007, Rregullorja e Disiplinës së Policisë së Shtetit miratuar me VKM nr. 786, datë 04.06.2008.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Asim Vokshi dhe si bisedoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, me detyrë specialist taktike në Seksionin e Operacioneve dhe Trajtimit, në Komisarjatin e Policisë Tiranë.

2. Pala e paditur ka filluar ndaj paditësit ecurinë disiplinore, duke vlerësuar se prej tij është shkelur neni 11 i Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit. Sipas konstatimeve paditësi ka shkelur nenet 60 dhe 62 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” si dhe nenin 11, pikat 5, 6 dhe 12 të Rregullores së Disiplinës së Policisë. Nga administrimi i të dhënave personale ka rezultuar se paditësi nuk figuronte nën efektin e ndonjë mase disiplinore.

3. Sa më sipër, me vendimin nr. 3, datë 06.01.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësit i është dhënë masa disiplinore “Përrjashtim nga Policia”. Kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar ankim pranë Komisionit të Apelit, i cili, me vendimin nr. 13, datë 02.02.2015, ka vendosur të konsiderojë të motivuar masën disiplinore të dhënë ndaj paditësit

4. Me urdhrin nr. 102/1, datë 04.02.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësi është përjashtuar nga Policia e Shtetit për shkak të dhënies së masës disiplinore.

5. Në këto rrethana, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 11.02.2015.

6. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2148, datë 22.04.2015, ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit Altin Morina. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit t’i paguajë paditësit Altin Morina 8 muaj pagë dëmshpërblim për shkak të përjashtimit të paligjshëm nga policia e shtetit (zgjidhjes pa shkak të përligjur të kontratës së shërbimit publik). Rrëzimin për sa u përket kërtimeve të tjera si të pabazuar në ligj.”

7. Kundër vendimit nr. 2148, datë 22.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e plotë të padisë.

8. Kundër vendimit nr. 2148, datë 22.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala e paditur, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar si argumente shkeljen e parimit të kontradiktoritetit, të barazisë së palëve si dhe moskryerjen e një hetimi të plotën e të gjithanshëm.

9. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2041, datë 01.10.2015, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 2148, datë 22.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësit Altin Morina. Shfuqizimin e vendimit nr. 3, datë 06.01.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, vendimit nr. 13, datë 02.02.2015, për shqyrtimin e ankesës për masë disiplinore dhe Urdhrit nr. 102/1, datë 04.02.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Altin Morina një dëmshpërblim prej 8 (tetë) pagash mujore. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit.”

10. Kundër vendimit nr. 2041, datë 01.10.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur **rekurs** pala paditëse, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 2148, datë 22.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

11. **Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë**, me vendimin e datës 11.09.2018 ka vendosur:

“Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në prani të palëve.”

12. Pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me kërkesën nr. 7066 prot., datë 30.12.2022 ka hequr dorë nga rekursi.

13. **Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë**, me vendimin e datës 09.01.2023 ka vendosur:

“Revokimin e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore datë 11.09.2018 dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh.”

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se duke qenë se pala e vetme rekursuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me vullnet të shfaqur me kërkesën nr. 7066 prot., datë 30.12.2022 ka hequr dorë nga rekursi, atëherë duhet të vendoset mospranimi i rekursit, në përputhje me nenet 480 e 490 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63(1)(a) të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar), si dhe neneve 480 dhe 490 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kundër vendimit nr. 2041, datë 01.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 02.02.2023